

Shtojca 21

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik X

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

AEK MUNELLA Shpk

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J98926001P

Nuis/Nipt

Reshen ,km 1.2 , Reshen -Ura Fanit ne krahun e djathte. 1000

Adresa

Rreshen

Shqiperi

1000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

+355694071263

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aek_shpk1@yahoo.it

E-mail

Adrian Kaza /Administrator

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

+355694071263

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Data (viti/muaji/dita)

12.07.2024

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)



Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF-12492-07-09-2024

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Mirdite

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

24 650 725 lekë (njetete katermilion e gjashtëqind e pesëdhjetemije e shtateqind e 25)

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).

RIKOSTRUKSION RRUGA JEZULL, NJESIA ADMINISTRATIVE RRESHEN NE BASHKINE MIRDITE

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

30.07.2024

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

8. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

LIGJI Nr. 162/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK
VENDIM NR. 285, DATË 19.05.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK (NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 710, DATË 24.11.2021)
REKOMANDIMI NR 1797/1 DATE 10.03.2022 I AGJENCISE SE PROKURORIMIT
PUBLIK

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Me datën 10.07.2024 Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirditë shpall ne faqen e APP-së objketin

RIKOSTRUKSION RRUGA JEZULL, NJESIA ADMINISTRATIVE RRESHEN NE BASHKINE MIRDITE me vlerë 24 650 725 lekë (njezete katermilion e gjashteqind e pesedhjetemije e shtateqind e njeze e pese) me numer **REF-12492-07-09-2024** procedur e hapur tipi: punë me afatin e fundit të dorëzimit të ofertës 30.07.2024.

Disa nga kërkesat e këtij objekt prokurorimi ne gjykimin tonë jane jo të drejta dhe jo në përputhje me **LIGJI Nr. 162/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhr VENDIM NR. 285, DATË 19.05.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK (NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 710, DATË 24.11.2021).**

Pasi kemi analizuar me kujdes Dokumentet Standarde të Tenderit dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin përkatës, shoqëria AEK Munella sh.p.k , ka konstatuar qe kriteret e vecanta dhe specifikimet teknike janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publikë, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar.

Për këtë arsye ne po ju drejtohem me këtë ankesë njëkohesisht Bashkisë Mirditë dhe Komisionit të Prokurimit Publik në respektimi të të gjitha afateve ligjore te percaktuara nga ligjet e sipercituara.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Në nenin 2 te Ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publikë parashikohet :

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 te Ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publikë parashikohet :

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 18 pika 1 te Ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publikë parashikohet :

1. Prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial. Procedurat e prokurimit duhet të kërkojnë standardet më të larta të etikës dhe besimit publik. Në çdo rast duhet të shmangët rreptësisht çdo konflikt interesi ose edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e titullarit të autoritetit kontraktor, punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Në nenin 36 te Ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publikë parashikohet :

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje

me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

Mbeshtetur në bazen ligjore të cituar më lart kemi konstatuar që hartimi i kriterëve për këtë procedurë është bërë në tejkalim të kompetencave që ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publik dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar i ka dhene autoritetit kontraktor për hartimin e kriterëve dhe specifikimet për procedurat e prokurimit publik. Me konkretisht këto konstatime po i paraqesim si më poshtë:

KERKESA 1

2.3.2/2 Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

****Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Në pikën 2.3.2./2 mendojmë se kjo pikë bie në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar”. Ne preventivin ku është publikuar ne sistemin SPE si me poshte

PREVENTIVI

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION RRUGA FSHATI JEZULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË
AUTORITETI KONTRAKTOR: BASHKIA MIRDITË



Nr	Nr. An (Manuali)	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI (lekë)	VLERA (lekë)
		Litola=1'613m. Dega kryesore: Litola=608m, L ₁ =310m me B ₁ =5.0m dhe B _{bas} =4.0m dhe L ₂ =298m me B ₂ =4.5m e B _{bas} =3.5m. Dega kodër Jezull Litola=908m me B=4.0m dhe B _{bas} =3.0m				
1	3.89/b	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet (për kanale, bankinë e kasonetë)	m ³	498.50	-	-
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	498.50	-	-
3	3.164/1b	Mbushje me çakell e gur gurore në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri (në trup rruge për nivelim me t _{max} =25cm)	m ³	1,488.98	-	-
4	3.207/1	Shtrese çakelli t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri	m ²	6,231.20	-	-
5	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m ²	6,231.20	-	-
6	3.224/2	Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri	m ²	4,776.60	-	-
7	3.233/1	Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 4cm, me makineri	m ²	4,776.60	-	-
8	3.244/1	Struktura të holla monolite betoni C 20/25 (kuletë e ngritje portal)	m ³	33.60	-	-
9	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm, bankina	m ²	1,174.60	-	-
10	3.949/1	Vizime me boja bikomponente me gjerësi 15 cm	ml	2,909.20	-	-
			1	SHUMA	-	-
			2	FOND REZERVË 2%	-	-
			3	SHUMA PA TVSH	-	-
			4	TVSH 20%	-	-
			5	SHUMA TOTALE	-	-

Ky preventiv bazohet në manualin e çmimeve të marrë nga e-albania (miratuar me VKM-në Nr. 216, datë 13.04.2023).
HARTUAR NË DATËN 31.05.2024.

Nga sa shikohet nga preventivi ketu nuk kemi zera të punimeve të tipit Gjeologjike, aty ka punime ndertimore.

Mendojem se Ing Gjeolog është kerkuar në kundërshtim nën 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

KERKESA 2

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukture transporti)

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Duka shqyrtuar preventivin e siper cituar dhe specifikimet teknike mendoje se ky kriter eshte kerkuar ne kundershtim me nenit 36 te Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

Ju vëjme në vëmendje dhe dijëni se në tre objekte që Bashkia Mirditë ka shpallur në faqen e APP-së, janë anuluar për shkak të gabimeve në përpilimin e dokumnetave standart te tenderit.

KERKESA 3

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, si më poshtë::

Teknik i mesëm ndërtimi	2 (dy)
Teknik i mesëm gjeodet/topograf	1 (një)
Karpentier	2 (dy)
Specialist per punime betoni (betonues)	1 (një)
Specialist per punime asfalti	4 (katër)
Eskavatorist	2 (dy)
Automakinist	2 (dy)
Buldozerist	2 (dy)
Shofer	6 (gjashtë)

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;
- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhen e kerkuar.
- Dokument (diplomë/certifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH". Per tekniket duhet te deklarohen dhe paraqitet diplome e shkolles se mesme teknike ndersa Për punonjesit Eskavatorist/Automakinist/Buldozerist/Shofer te paraqiten leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).

Per te gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punes; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatin e vlefshmerise se saj; numrin e diplomës/certifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimit nga DPSHTRR dhe afatin e vlefshmerise se saj si edhe autoritetin leshues te saj shoqeruar me niptin perkates kur keto autoritete jane private.

Mendojmë se kjo kërkesë është në tejkalim të LPP dhe VKM-së.

Duke shqyrtuar preventivin e objektit shikojmë se zërat e punimeve më kërkesat e kësaj pike nuk përputhen. Kërkohen 2 teknik ndertimi, ne zbatim te LPP ne mendojme se 1 teknik eshte i pranushme ,1 Teknik i mesëm gjeodet/topograf ,2 Karpentier, 1 Specialist per punime betoni

(betonues) , 4 Specialist per punime asfalti , 2 Eskavatorist ,2Automakinist,2 Buldozerist, 6 Shofer, këta punonjës që kërkohet nuk kanë se si mund të kërkohen kaq shume se në këtë preventiv siper cituar nuk ka punime ku volumi i punes eshte aq i madhe dhe se koha e cila duhet te mbaroj objekti eshte mjaftueshem ne rraport me volumet qe jane ne preventiv.

Pra keto kritere jan fryr me pa nje llogjik pune , pa u bazuar ne punimet qe kerkohen ne preventiv dhe pa rrespektuar frymen e ligjit dhe ne kundershtrim të nenit 36 të LPP.

KERKESA 4

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 6
2	Kamionçinë vetëshkarkuese	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion me vinç të integruar	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autogreider me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Autopompë betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Eskavatorë me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rul gomë-hekur mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Rul gomë-hekur mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Rul hekur-hekur mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Rul gome-gome mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Rul hekur-hekur i vogel 2-4 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Vibratorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Minieskavatorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Minifadromë	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Aparat topografik GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
24	Total station	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Deflektometer	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Fabrikë asfaltobetoni (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

27	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
28	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
29	Makineri vizimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
30	Tabela sinjalizuese kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 10
31	Kaska/kokore	në pronësi ose me qira	Copë 25
32	Jeleke kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 25
33	Komplet i ndihmes shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 3

Dhe kjo pikë e dst mendojmë se nuk është në përputhje me nenin 36 të LPP dhe VKM-së për arsye se makinerit që kërkohen nuk janë në përputhje me punimet që kërkohen të kryhen. Makineria që kërkohet janë të mbikerkuar dhe në kalim të absurditë. Këto makineri nuk kanë si të kërkohen se janë të pa përshtatshme për këtë objekt.

Makinerit e siperkerkuar nuk janë në përputhje me LPP dhe VKM-ne. Nga Nr 1 deri në Nr 33 makineret janë kerkuar jashtë asaj që mund të duhet.

Për sa më sipër sa u tha mëndojmë se këto kritere të vendosura nga autoriteti kontraktorë janë jo në përputhje me LPP dhe VKM-së.

Mendojmë se nuk duhet të devijohet nga fryma e ligjit i cili duhet të jetë i drejtë dhe i barabart për të gjithë.

KERKESA 5

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001: 2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

- *Liçence leshuar nga QKL me kod III-2-B“Per grumbullim dhe transportim mbetjesh jo te rrezikshme”*

Kjo kerkes eshte ne kalim te cdo lloje kompetence qe mund ti jap ligji per caktuar kriteret per te kryer nje pune publike.

Liçence leshuar nga QKL me kod III-2-B“Per grumbullim dhe transportim mbetjesh jo te rrezikshme” kjo license i jepet kompanive te cilat ka ne pronesi ose qera nje ambjet i cili eshte i pershtatshem per grumbullimin e mbetjeve dhe nuk ka sit e kerkohet per kopanit qe kryejn procese ndertimore. Mund te ishte kerkuar nje marveshje per mbeturinat qe dalin nga objekti te dergohet ne piken me te afert.

Kjo pike e mesiperme eshte ne kundersiztim me LPP dhe VKM.

KERKESA 6

*2.4.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se nuk ka asnjë detyrim ndaj bashkisë Mirditë dhe as dëm ekonomik të pashlyer të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Asnjë operator ekonomik nuk do të shpallet fitues nëse ka detyrime, apo dëm ekonomik të lënë nga KLSH-ja, të pashlyer ndaj bashkisë Mirditë. Kjo është një formë që bashkia Mirditë zgjedh për të plotësuar rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.*

Me sa duket me kete kerkes Autoriteti Kontraktor ben parashikmi se kush duhet te fitoj dhe kush nuk duhet ta fitoj objektin e prokurorimit.

Ky kriter eshte ne kundersiztim me LPP dhe VKM. Foramt e zabtimit te rekomandimeve te KLSH-se jane te qarte ne legjiclacionin shqiptare me sakt jane te rregulluar me LIGJ Nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe jo nga mendimet e Qeverisjes Vendore.

Kushtetuta e Rrepublikes se Shqiperis eshte mjete i cili rregllon te drejtat dhe lirete themelore te cdo individi.

Në përfundim të të gjitha arsyetimeve dhe mbi bazën e ligjeve të cituara, rekomandimeve të APP dhe vendimeve unifikuese të KPP kerkojme:

- 1- Pranimin e ankeses si të bazuar ne ligj dhe prova
- 2- Kriteri të ndryshohen dhe të hartohen sipas parashikimieve ligjore dhe të mos jenë në tejkalim të Ligjeve për prokurimin publik, rekomandimet e APP dhe vendimet unifikuese te KPP.

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk Ka _____

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar